



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 553/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.08.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:	Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Ave Consulting” sh.p.k & “Taulant” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr.REF-28482-06-26-2019, me objekt: <i>“Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve per objektin “Rikualifikimi i Sheshit Italia”, me fond limit 5.069.033 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 08.07.2019 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).</i>
Ankimues:	BOE “Ave Consulting” sh.p.k & “Taulant” sh.p.k Rruga “Tish Daija”, P.7, Ap.28, Kompleksi Kika i Ri, Tiranë
Autoriteti Kontraktor:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë
Baza Ligjore:	Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 <i>“Për Prokurimin Publik”</i> , i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 <i>“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”</i> , i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 <i>“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik</i>

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.06.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr.REF-28482-06-26-2019, me objekt: “*Sherbimi i mbikqyrjes së punimeve per objektin “Rikualifikimi i Sheshit Italia”*”, me fond limit 5.069.033 lekë pa tvsh, zhvilluar nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).

II.2. Në datën 08.07.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 15.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

“Ave Consulting” sh.p.k	3.041.400 lekë, skualifikuar
“He &Sk 11” sh.p.k	3.850.555 lekë, skualifikuar
“InfraKonsult” sh.p.k	4.207.297 lekë, skualifikuar

“Derbi E” sh.p.k	4.257.988 lekë, skualifikuar
“Instituti i Konsulemcës në Ndërtim “IKN”	4.513.831 lekë, skualifikuar
“Zenit & CO” sh.p.k	4.517.926 lekë, skualifikuar
“Novatech Studio” sh.p.k	4.632.987 lekë, skualifikuar
“A&E Engineering” sh.p.k	4.635.000 lekë, skualifikuar
“Arena” sh.p.k	4.650.000 lekë, skualifikuar
“6D Plan” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“A.Sh.Engineering” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“Archispace” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“Civil Cons” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“Gjeokonsult&Co” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“Net Group” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“Tower” sh.p.k	4.761.301 lekë, kualifikuar
“KKG Project” sh.p.k	4.762.000 lekë, kualifikuar

BOE “Ave Consulting” sh.p.k & “Taulant” sh.p.k” shpk është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

“Vlera e ofertës është nën vlerën minimale të percaktuar sipas VKM.”

II.4. Në datën 22.07.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...] Referuar ligjit po japim shpjegimet tona të argumentuara në llogaritjen e ofertës sonë të detajuar:

Për këtë procedurë prokurimi, sipas dokumentave të tenderit, për realizimin me sukses duhej ky ekip minimal:

Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet

a. Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në ekipin e tij minimalisht:

Drejtuues teknik (Inxhinier ndërtimi) 1 (një)

Inxhinier topograf minimalisht 1 (një)

Inxhinier mekanik minimalisht 1 (një)

Inxhinier elektrik minimalisht 1 (një)

Inxhinier hidroteknik minimalisht 1 (një)

Arsyetimi ynë për ofertën tonë 3.041.400 është si më poshtë:

Nr	Emer Mbiemer	Paga Bruto	Taksat e Pagave (Sigurime 27.9% + Tap)				Totali i Taksave që duhen paguar (Sigurime + Tap)	Paga Neto	
			Sigurime						Tap
			Punëdhënësi		Punëmarrësi				
Sig. Shoq Punëdhënësi	Sig. Shënd	Sig. Shoq Punëdhënësi	Sig. Shënd	f* 0% + 13% + 23%	g = b + c + d + e + f	h = a - d - e - f			
		a	b = a * 15%	c = a * 1.7%	d = a * 9.5%	e = a * 1.7%			
1	Drejtuuesi teknik (Inxhinier ndërtimi) 1 (një)	162,011	17,201	2,754	10,894	2,754	18,363	51,966	130,000
2	Inxhinier topograf minimumi 1(një)	125,432	17,201	2,132	10,894	2,132	12,406	44,765	100,000
3	Inxhinier mekanik minimumi 1(një),	125,432	17,201	2,132	10,894	2,132	12,406	44,765	100,000
4	Inxhinier elektrik minimumi 1(një),	125,432	17,201	2,132	10,894	2,132	12,406	44,765	100,000
5	Inxhinier hidroteknik minimumi 1 (një),	125,432	17,201	2,132	10,894	2,132	12,406	44,765	100,000
							231,025	530,000	
Shpenzime totale për stafin e kërkuar - paga bruto mujore								761,025	

Tabela e mësipërme jep shpenzimet mujore të pagës për inxhinierët e kërkuar.

<i>Tabela përmbledhëse e shpenzimeve mujore</i>	
<i>Shpenzime paga mujore</i>	<i>761.026</i>
<i>Shpenzime të drejtpërdrejta 11%</i>	<i>83.807</i>
<i>Shuma</i>	<i>844.833</i>
<i>Fitimi 15%</i>	<i>168.967</i>
<i>Vlera totale për 1 muaj</i>	<i>1.013.800</i>
<i>Vlera totale për tre muaj</i>	<i>3.041.400</i>

Tabela e shpenzimeve përfundimtare për tre muaj.

Pra referuar tabelave të detajuara të mësipërme shpenzimet për pagat, shpenzimet e drejtpërdrejta si dhe fitimi i shoqërisë, oferta jonë është me % më të madhe sec specifikohet në ligjin nr. 629, datë 15.07.2015 ku vlera e shpenzimeve dhe fitimi i shoqërisë është përkatësisht 8% shpenzimet dhe 10% fitimi.

Gjithashtu edhe paga e inxhinierëve që ne paguajmë është pagë mbi mesataren e pagave të të njëjtit pozicion në sektorin privat dhe atë shtetëror.

Ne si BO kemi vendosur dhe % pak më të lartë se ato referuese në ligjin e sipërcituar. Sipas arsytimit të skualifikimit, ku oferta jonë është anomalisht e ulët, nuk qëndron, pasi sipas llogjikës suaj, të gjitha kompanitë duhet të rrisin % e shpenzimeve si dhe % e fitimit, gjë që nuk është normale. Gjithashtu në vlerësimin tuaj duket se oferta e njëjtë e 8 operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, gjë që na con të mendojmë se ofertat e këtyre operatorëve janë të caktuara. Referuar detajimit të ofertës sa më sipër, ne si bahkim operatorësh mendojmë se vlera totale e ofertës tonë është e llogjikshme bazuar në fakte dhe në argumentimin e dhënë.”

II.5. Me shkresën nr.1097/1 prot datë 25.07.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 31.07.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.1132/2 prot datë 06.08.2019 protokolluar me tonën me nr.1337/2 prot datë 06.08.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të ankimuesit sipas së cilës: *“Vlera e ofertës është nën vlerën minimale të përcaktuar sipas VKM”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në dokumentat e tenderit *“Njoftimi i kontratës”*, Seksioni 4, pika 4.2., nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

4.2 *Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:*

A) *çmimi më i ulët X*

(në përputhje me VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit”).

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1132/2 prot datë 06.08.2019 protokolluar me tonën me nr. 1337/2, datë 06.08.2019, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, përlllogaritja e fondit limit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga autoriteti kontraktor është bërë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*.

III.1.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”* sipërcituar në nenin 1 të tij *“Fusha e Veprimt”* parashikon shprehimisht se: *Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.*

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: *Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP. Pika 3 e nenit 7 parashikon se: Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa tarifa minimale të specifikuar nga ky manual.*

III.1.4. Në Rekomandimin Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 të APP-së; *“Rekomandim mbi menyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*, parashikohet si më poshtë:

- *Per shërbimet e parashikuara në vendimin e sipërcituar (Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon që, krahas përlllogaritjes së fondit limit (i cili përlllogaritet nisur nga përqindja maksimale e lejuar), behet përlllogaritja e vlerës minimale të lejuar (e cila përlllogaritet nisur nga përqindja minimale e lejuar), në varesi të kategorisë dhe grupit tarifor, ku bën pjesë objekti i prokurimit*
- *Ne nenin 7, pika 3, të vendimit të sipërcituar, parashikohet se: “Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund të jenë më të ulëta sesa normat minimale, të specifikuar nga ky manual”.*

- *Ne kete kontekst rekomandojme qe, ne rastet kur nuk dokumentohet rrethana e jashtezakonshme, autoritetet kontraktore gjate vleresimit te ofertave, duhet t'i referohen vleres minimale te perlllogaritur per secilin rast, ne baze te parashikimeve ne VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*
- *Ne paraqitjen e ofertave ne kete lloj procedure prokurimi, operatoret ekonomike duhet te mbajne ne konsiderate edhe vlerat minimale te perlllogaritura nga autoritetet kontraktore ne zbatim te VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, në rastin konkret, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni i detajuar i dhënë nga autoriteti kontraktor, kryesisht në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, konstaton se, nga ky i fundit janë bërë përlllogaritjet për përcaktimin e vlerave minimale e maksimale të mbikëqyrjes, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Qëllimi i VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” është që të mbrojtë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Efekt i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përafuar nivelin e pagave që ato t’i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm.

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaçëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë, nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

Në përlllogaritjen e fondit limit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar edhe vlerën minimale nën të cilën çdo operator ekonomik do të skualifikohej për ofertë të papërgjegjshme dhe jo në përputhje me përcaktimet e posaçme ligjore në fuqi dhe në rastin konkret, kur ekziston një bazë ligjore e posaçme që rregullon vlerat minimale, çdo autoritet është i detyruar ta ketë parasysh gjatë vlerësimit të ofertave dhe ta zbatojë atë me përpikmëri.

Autoriteti kontraktor sqaron se ai që në përlllogaritjen e fondit limit është bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe thekson se objekti klasifikohet në grupin V tarifor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vlerësimi i ofertave është kryer duke mos aplikuar formulën për ofertën anomalisht të ulët, referuar ligjit për prokurimin publik, por i është referuar vlerave minimale, pasi ankimuesi ka paraqitur një ofertë të papërgjegjshme dhe nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë, pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorëve, përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave.

III.1.6. Referuar relacionit mbi hartimin e termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit për tenderin “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve për objektin “Rikualifikimi i Sheshit Italia”, mbajtur nga grupi i punës pranë autoritetit kontraktor, i ngarkuar me detyrën e përllogaritjes së fondit limit, rezulton se vlera minimale e mbikëqyrjes për objektin në fjalë është në vlerën 4.761.301 lekë pa tvsh.

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të BOE “Ave Consulting” sh.p.k & “Taulant” sh.p.k rezulton se vlera e ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi është 3.041.400 pa tvsh. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vlera e ofertuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk është në përputhje me VKM nr. Nr.354 datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”, dhe rekomandimin e APP-së, pasi është shumë më e ulët se vlera minimale e përllogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se duke qenë se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura.

Në këtë kuptim, Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, BOE “Ave Consulting” sh.p.k & “Taulant” sh.p.k, ka ofertuar me një vlerë e cila rezulton të jetë nën vlerën minimale të lejuar të përllogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Ave Consulting” sh.p.k & “Taulant” sh.p.k” shpk për procedurën e prokurimit, me Nr.REF-28482-06-26-2019, me objekt: *“Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve per objektin “Rikualifikimi i Sheshit Italia”, me fond limit 5.069.033 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 08.07.2019 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).*
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1337 Protokolli;

Datë 31.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha